

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 10 112, DATË 9.4.2009
“PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESET E BANIMIT””

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2 “Përkufizimet” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Pika 4 ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. “Asambleja e bashkëpronarëve” është organi vendimarrës i bashkëpronarëve në një ndërtesë në bashkëpronësi dhe përbëhet nga tërësia e bashkëpronarëve në një ndërtesë në bashkëpronësi, pavarësisht llojit të njësisë që çdo bashkëpronar ka në pronësi të tij.”

Pika 6 ndryshohet si më poshtë vijon:

“6. “Administrator” është personi fizik ose juridik, i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit ose pranë organeve të administratës tatimore, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e shoqërive tregtare, i përfshirë në librin e administratorëve, të mbajtur nga bashkia, për të ushtruar veprimtari në fushën e administrimit të ndërtesave dhe që është kontraktuar për administrimin e ndërtesës në bashkëpronësi.”

Pika 7 “Shoqëria Administruese” shfuqizohet.

Pika 9 ndryshohet si më poshtë vijon:

“9 “Njësi” është një pjesë e ndërtesës së banimit me destinacion specifik urban, siç është përcaktuar në lejen e ndërtimit, që është në pronësi individuale, e cila, së bashku me kuotën e pjesëmarrjes në bashkëpronësi, përbën një pjesë të veçantë pasurie të paluajtshme. Njësia mund të jetë njësi banimi, shërbimi ose administrative.”

Pas pikës 9, shtohet pika 9/1 me këtë përmbajtje:

“9/1. “Ndërtesë banimi” është objekti i përbërë nga disa njësi.”

Pika 10 ndryshohet si më poshtë vijon:

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10 112 DATË 9.4.2009
“PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESET E BANIMIT”

"10. "Pronar i njësisë" është një ose më shumë individë, persona fizikë ose juridikë, që ka ose kanë në pronësi një njësi."

Pas pikës 15, shtohet pika 16 me këtë përmbajtje:

"16. "Kompleks rezidencial" është tërësia e ndërtesave, të cilat kanë të regjistruar në pronësi të përbashkët truallin e kompleksit, infrastrukturën, impiantet në funksion dhe në përdorim ekskluziv të pronarëve të ndërtesave".

Neni 2

Në nenin 5, pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

"3. Në komplekse rezidenciale, janë në pronësi të përbashkët të gjithë elementët e përcaktuar në aktin e kalimit të pronësisë, që nuk i përkasin njësisë individuale dhe ata elementë në funksion dhe në përdorim të përbashkët të pronarëve të çdo njësie individuale, përderisa në akt nuk është cilësuar ndryshe, të tilla si:

- a) territori i kompleksit;
- b) impiante në funksion të kompleksit, si depo uji, kabina elektrike, pishina, sisteme vaditëse, ndriçimi, si dhe çdo sistem tjetër për përdorim të përbashkët;
- c) elementë natyrorë si pemë, parqe e hapësira të gjelbëruara.

Neni 3

Në nenin 7 "Përmbajtja e aktit të bashkëpronësisë" pika 1, shkronja "a" ndryshohet si më poshtë vijon:

"a) dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim, në përputhje me kërkesat e ligjit "Për kadastrën";

Neni 4

Në nenin 12 "Detyrimet dhe të drejtat e qiramarrësve", në fund të fjalisë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: "përveçse kur në kontratën e qirasë apo akt tjetër, pronari u ka dhënë të drejta përfaqësimi në asamble, si të ishte vetë pronari".

Neni 5

Në nenin 14 "Asambleja e bashkëpronarëve", pas pikës 3, shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: "4. Pronarët mund të marrin pjesë personalisht në mbledhje apo të autorizojnë një përfaqësues."

Neni 6

Në nenin 15 "Regjistrimi i kryesisë", pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon: "1. Një kopje e vendimit për zgjedhjen e kryesisë depozitohet për regjistrim në organet e vetëqeverisjes vendore. Organet e vetëqeverisjes vendore krijojnë regjistrin e bashkëpronësisë, i cili duhet të përmbajë emrat e anëtarëve të kryesisë, administratorit dhe adresën e ndënesës së banimit."

Neni 7

Në nenin 17 "Kompetencat e veçanta të asamblesë së bashkëpronarëve", bëhen këto ndryshime:

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10 112 DATË 9.4.2009
"PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESET E BANIMIT"

Në pikën 1, shkronja "dh" shfuqizohet;

Në pikën 1, në shkronjën "e", pas togfjalëshit "...dhe përcakton kriteret e përdorimit të tij", shtohet "...duke autorizuar kryesinë për këtë qëllim."

Në pikën 1, para shkronjës "g" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"f) Miraton kërkesat për ndryshimin e pamjes së pronës së përbashkët ose pamjen e jashtëme të njësisë individuale pjesë e një kompleksi rezidencial dhe kërkesat për ndërtime në katin e fundit të një ndërtese apo ndërtime mbi katin e fundit të njësisë individuale pjesë e një kompleksi rezidencial sipas nenit 34 të këtij ligji."

Neni 8

Pas nenit 17, shtohet neni 17/1, me këtë përmbajtje:

"Neni 17/1

Kompetencat e veçanta të kryesisë

1. Përveç kompetencave të përcaktuara në këtë ligj, kryesia ka edhe këto kompetenca:

- a) autorizon administratorin për të kërkuar lëshimin e urdhrin të ekzekutimit, sipas pikës 2 të nenit 27 të këtij ligji, si dhe për ndjekjen deri në fund të ekzekutimit, për mospagesën e tarifës së administrimit nga ndonjëri prej bashkëpronarëve;
- b) përdor/prek fondin rezervë ose autorizon administratorin të përdorë/prekë fondin rezervë, sipas kriterëve të përdorimit të përcaktuara nga asambleja e bashkëpronarëve;
- c) përfaqëson asamblenë e bashkëpronarëve në raport me të tretët për kryerjen e veprimeve juridike me qëllim administrimin e bashkëpronësisë;
- ç) çdo detyrë tjetër të caktuar nga asambleja e bashkëpronarëve."

Neni 9

Në nenin 18 "Vlefshmëria e vendimeve", pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1 . Në rast mosarritje të kuorumit të asamblesë së bashkëpronarëve, siç parashikohet në pikën 1 të këtij neni, edhe pas të paktën 2 (dy) njoftimesh paraprake, asambleja mund të vendosë në lidhje me çështjet e rendit të ditës, pa u mbledhur, nëpërmjet vendimit qarkullues. Vendimi qarkullues konsiderohet i vlefshëm nëse është nënshkruar nga shumica e bashkëpronarëve siç parashikohet nga dispozitat e Kodit Civil dhe të këtij ligji."

Neni 10

Në nenin 19 "Format e administrimit të bashkëpronësisë", bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 1 paragrafi parë, fjala "mund" zëvendësohet me fjalën "duhet";

Në pikën 1, shkronja "a" shfuqizohet.

Në pikën 1, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë vijon:

"një administrator, person juridik ose person fizik, që mund të jetë njëri prej bashkëpronarëve apo një person i jashtëm."

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10 112 DATË 9.4.2009
"PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRITESAT E BANIMIT"

Në pikën 2, në fund të fjalisë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Bashkëpronarët kanë detyrimin të caktojnë një administrator. sipas këtij ligji, në rast se ndërtesa ka në bashkëpronësi më shumë se katër bashkëpronarë. Nëse një vendim i tillë nuk merret nga asambleja e bashkëpronarëve apo kryesia, kompetencën për caktimin e administratorit e ka kryetari i njësisë administrative.”

Pas pikës 2, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Pas përfundimit të kontratës, administratori ka detyrim t'i kthejë menjëherë kryesisë të gjithë dokumentacionin e mbajtur në lidhje me ndërtesën në bashkëpronësi.”

Neni 11

Neni 20 ndryshon në titull dhe përmbajtje si më poshtë vijon:

Titulli “Përgjegjësitë e administratorit / shoqërisë administruese” zëvendësohet me “Administratori dhe përgjegjësitë e tij”.

Pika 3 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Formati i kontratës tip, që lidh kryesia me administratorin, miratohet me udhëzim të përbashkët të ministrit që mbulon fushën e strehimit dhe të Ministrit të Drejtësisë, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe të këtij ligji.”

Në pikën 3, në fund të fjalisë shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“3. Pas përfundimit të kontratës, administratori ka detyrimin t'i kthejë menjëherë kryesisë të gjithë dokumentacionin tekniko-ligjor të mbajtur gjatë administrimit të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, të kryer në ndërtesën në bashkëpronësi në ngarkim të tij.”

Neni 12

Neni 21 ndryshon në titull dhe përmbajtje si më poshtë vijon:

Titulli “Shoqëritë Administruese” zëvendësohet me “Administratori”.

Në pikën 1, togfjalëshi “Shoqëritë administruese” zëvendësohet me “Administratori”.

Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Nëse administratori, gjatë përmbushjes së veprimtarisë në këtë fushë, kryen veprime në kundërshtim me ligjin apo kontratën e lidhur mes palëve, atëherë bashkia, njësia administrative apo 1/10 e bashkëpronarëve të interesuar mund t'i drejtohen gjykatës kompetente të rrethit gjyqësor ku ndodhet ndërtesa, për heqjen e tij nga libri i administratorëve. Gjykata, në vendimin e saj, në rast se vendos që, individi apo subjekti duhet të hiqet nga libri i administratorëve, do të shprehet edhe për detyrimet që ka ky i fundit ndaj asamblesë së bashkëpronarëve që e ka kontraktuar.

Neni 13

Neni 23 ndryshon në titull dhe përmbajtje si më poshtë vijon:

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10/112 DATË 9.4.2009
“PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESET E BANIMIT”

Titulli "Moskontraktimi i një subjekti administrues" zëvendësohet me "Moskontraktimi i Administratorit".

Në pikën 1, në mes të fjalisë, fjala "kontraktojë" zëvendësohet me fjalën "caktojë".

Në pikën 1, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë vijon:

"b) një asamble nuk merr vendim për formën e administrimit brenda 3 (tre) muajve nga data e konstituimit të saj;"

Në pikën 1, pas shkronjës "b", shtohen shkronjat "c" dhe "ç" me këtë përmbajtje:

"c. kryesia nuk kontraktin një administrator, brenda afatit të parashikuar në ligj;

ç. të gjitha rastet kur kryesia nuk ka arritur të zgjedhë administratorin."

Në pikën 3, togfjalëshi "të ardhurat e bashkisë /komunës" zëvendësohet me fjalën "administratori".

Neni 14

Neni 27 ndryshon në titull dhe përmbajtje si më poshtë vijon:

Titulli "Pagesa e tarifës së administrimit" zëvendësohet me "Pagesa e tarifës së administrimit dhe ekzekutimi i detyrimeve monetare".

Pas pikës 1, shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Vendimet e asamblesë së bashkëpronarëve që përcaktojnë detyrime monetare në ngarkim të bashkëpronarëve, si rrjedhojë e mospagesës së tarifës së administrimit, përbëjnë titull ekzekutiv në kuptimin e shkronjës "e" të nenit 510 të Kodit të Procedurës Civile."

Në pikën 2, togfjalëshi "kryesia ose shoqëria e administrimit" zëvendësohet me "administratori".

Neni 15

Në nenin 34 "Ndryshimi i njësive nga pronarët", bëhen ndryshimet si vijon:

Në pikën 2, pas togfjalëshit "...pamjen e pronës së përbashkët", shtohet shprehja "...ose pamjen e jashtme të së njësisë individuale pjesë e një kompleksi rezidencial, duke përfshirë këtu arkitekturën, si fasadën, veshjet, kornizat, dyert, hyrjet, tjegullat, oxhaqet, dritaret, grilat, ngjyrën, stilin".

Pas pikës 2, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"2/1. Pronari i njësisë, pjesë e një kompleksi rezidencial, mund të bëjë ndërtime në katin e fundit të njësise se tij individuale dhe, kur është pronar i truallit mund të bëjë edhe shtesë

anësore, vetëm pasi për ndryshimin e pamjes së kompleksit, ka marrë më parë miratimin me shumicë të cilësuar votash në përputhje me nenin 218 të Kodit Civil.”

Neni 16

Pas nenit 37 shtohet “Neni 37/1” me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

“Ndërtesat në rrezik shembjeje”

1. Kur, gjatë inspektimit të objekteve në bashkëpronësi, sipas nenit 37, konstatohen dëmtime serioze, që përbëjnë rrezik për shëmbje totale (si ndërhyrje në themele ose mur mbajtës) apo dëmtime të pjesshme të ndërtesës së banimit, inspektoriati vendor harton një raport të hollësishëm mbi gjendjen e ndërtesës së banimit, duke paraqitur propozime konkrete për masat që duhen të ndërmerren nga asambleja e bashkëpronarëve dhe njësia e vetëqeverisjes vendore për rivendosjen e sigurisë së saj. Ky raport i vihet menjëherë në dispozicion edhe asamblesë së bashkëpronarëve.
2. Në çdo rast, asambleja e bashkëpronarëve ka të drejtë të kontraktojë një subjekt privat për vlerësimin e qëndrueshmërisë së ndërtesës.
3. Nëse asambleja e bashkëpronarëve nuk merr masat e nevojshme për rivendosjen në siguri të ndërtesës, sipas pikës 1 të këtij neni, ndërhyrjet kryhen nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe shpenzimet i ngarkohen bashkëpronësisë.
4. Në rast se gjendja e ndërtesës së banimit rezulton të jetë e dëmtuar apo e amortizuar në mënyrë të pariparueshme dhe paraqet rrezik të afërt shembjeje me pasoja për jetën, shëndetin e njerëzve apo pasurinë e të tretëve, inspektoriati vendor, pasi të ketë marrë me parë pëlqimin e 75 % të asamblesë, i propozon njësisë së vetëqeverisjes vendore shembjen e saj.”

Neni 17

Në nenin 40 bëhen ndryshimet në titull dhe përmbajtje si më poshtë vijon:

Titulli “Bashkëpunimi me asambletë e bashkëpronarëve” zëvendësohet me “Bashkëpunimi ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore me asamblenë e bashkëpronarëve”.

Pika 2 riformulohet si vijon:

“2. Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të kontribuojnë në financimin pjesor për ngritjen e një ndërtese të re, kur bashkëpronarët vendosin për ta shembur atë ose kur ndodhemi përpara rasteve të parashikuara nga neni 37/1, pika 2, me kusht që pjesë nga ndërtesa e re t'i kalojnë në pronësi këtyre njësive, për t'ua dhënë në përdorim apo pronësi familjeve në vështirësi për strehim, pasi janë akomoduar bashkëpronarët sipas pjesëve takuese.”

Neni 18

Pas nenit 40, shtohet neni 40/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 40/1

Financimi nëpërmjet fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe administratorit

1. Përveç sa parashikohet në nenin 40, administratori, me iniciativë të tij, mund t'i propozojë asamblesë së bashkëpronarëve realizimin e punimeve të rindërtimit apo restaturimit të ndërtesës në bashkëpronësi, nëpërmjet financimit me fondet e bashkisë dhe administratorit, kundrejt pagesës së shpenzimeve të realizuara nga ky i fundit, sipas një plani të detajuar shlyerjeje të shpenzimeve, i cili përmban në mënyrë të detajuar kështet dhe afatet kohore përkatëse të pagesave. Për këtë qëllim, administratori i paraqet asamblesë së bashkëpronarëve një raport të hollësishëm rreth punimeve të nevojshme, preventivit të punimeve, kostove financiare dhe planit të pagesës në bazë të të cilit asambleja do të shlyejë detyrimet monetare kundrejt administratorit.

2. Asambleja miraton, me votat e bashkëpronarëve që zotërojnë 75% të kuotave pjesëmarrëse në bashkëpronësi, propozimin e administratorit dhe autorizimin e tij për të aplikuar për financim pjesor nga bashkia përkatëse, siç parashikohet në nenin 40, në emër dhe për llogari të asamblesë së bashkëpronarëve."

Neni 19

Në nenin 43, pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

"1. Për ndërtesat e peregjistruara në zyrën përgjegjëse për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, por që përdoren nga porositësit e tyre, garant për zbatimin e këtyre rregullave, është shoqëria ndërtuese (sipërmarrësi) dhe, në rast falimentimi të saj, është njësia e vetëqeverisjes vendore."

Neni 20

Në nenin 44, pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

"2. Nëse për një periudhë prej 3 (tre) muajsh nga kolaudimi i ndërtesës, nuk është lëshuar ende certifikata e shfrytëzimit / përdorimit nga autoritet përgjegjëse, krijuesi i bashkëpronësisë (shoqëria ndërtuese) organizon mbledhjen për formimin e asamblesë së porositësve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data kur 1/3 e kuotave pjesëmarrëse në bashkëpronësi ka porositës të përcaktuar (identifikuar) në bazë të një kontrate sipërmarrje. Krijimi dhe ushtrimi i kompetencave nga asambleja e porositësve rregullohet sipas dispozitat të Kreut V, neni 14 deri në nenin 19, të këtij ligji, derisa të merret certifikata e shfrytëzimit dhe titulli i pronësisë së ndërtesës t'u kalojë porositësve."

Neni 21

Kudo në ligj, emërtimi "njësi të qeverisjes vendore" zëvendësohet me emërtimin "njësi të vetëqeverisjes vendore"; emërtimi "inspektoriati ndërtimor dhe urbanistik i bashkisë /komunës", zëvendësohet me emërtimin "inspektoriati i mbrojtjes së territorit të njësisë vendore"; emërtimi "administrator/shoqëri e administrimit" zëvendësohet me fjalën "administrator"; emërtimi "zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose ZRPP" zëvendësohet me "zyra përgjegjëse për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", fjala "komuna" hiqet, fjala "shoqëri administruese" hiqet.

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më / / 2021.

Miraturar në datën / / 2021.

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10 112 DATË 9.4.2009
"PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESE E BANIMIT"

KRYETARI

Gramoz Ruçi

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10 112 DATË 9.4.2009
"PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESAT E BANIMIT"

1. Përveç sa parashikohet në nenin 40, administratori, me iniciativë të tij, mund t'i propozojë asamblesë së bashkëpronarëve realizimin e punimeve të rindërtimit apo restaturimit të ndërtesës në bashkëpronësi, nëpërmjet financimit me fondet e bashkisë dhe administratorit, kundrejt pagesës së shpenzimeve të realizuara nga ky i fundit, sipas një plani të detajuar shlyerjeje të shpenzimeve, i cili përmban në mënyrë të detajuar kështet dhe afatet kohore përkatëse të pagesave. Për këtë qëllim, administratori i paraqet asamblesë së bashkëpronarëve një raport të hollësishëm rreth punimeve të nevojshme, preventivit të punimeve, kostove financiare dhe planit të pagesës në bazë të të cilit asambleja do të shlyejë detyrimet monetare kundrejt administratorit.

2. Asambleja miraton, me votat e bashkëpronarëve që zotërojnë 75% të kuotave pjesëmarrëse në bashkëpronësi, propozimin e administratorit dhe autorizimin e tij për të aplikuar për financim pjesor nga bashkia përkatëse, siç parashikohet në nenin 40, në emër dhe për llogari të asamblesë së bashkëpronarëve.”

Neni 19

Në nenin 43, pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Për ndërtesat e peregjistruara në zyrën përgjegjëse për regjistrimin e pasurive të paluajtshme, por që përdoren nga porositësit e tyre, garant për zbatimin e këtyre rregullave, është shoqëria ndërtuese (sipërmarrësi) dhe, në rast falimentimi të saj, është njësia e vetëqeverisjes vendore.”

Neni 20

Në nenin 44, pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Nëse për një periudhë prej 3 (tre) muajsh nga kolaudimi i ndërtesës, nuk është lëshuar ende certifikata e shfrytëzimit / përdorimit nga autoritet përgjegjëse, krijuesi i bashkëpronësisë (shoqëria ndërtuese) organizon mbledhjen për formimin e asamblesë së porositësve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data kur 1/3 e kuotave pjesëmarrëse në bashkëpronësi ka porositës të përcaktuar (identifikuar) në bazë të një kontrate sipërmarrje. Krijimi dhe ushtrimi i kompetencave nga asambleja e porositësve rregullohet sipas dispozitat të Kreut V, neni 14 deri në nenin 19, të këtij ligji, derisa të merret certifikata e shfrytëzimit dhe titulli i pronësisë së ndërtesës t'u kalojë porositësve.”

Neni 21

Kudo në ligj, emërtimi “njësi të qeverisjes vendore” zëvendësohet me emërtimin “njësi të vetëqeverisjes vendore”; emërtimi “inspektoriati ndërtimor dhe urbanistik i bashkisë /komunës”, zëvendësohet me emërtimin “inspektoriati i mbrojtjes së territorit të njësisë vendore”; emërtimi “administrator/shoqëri e administrimit” zëvendësohet me fjalën “administrator”; emërtimi “zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ose ZRPP” zëvendësohet me “zyra përgjegjëse për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, fjala “komuna” hiqet, fjala “shoqëri administruese” hiqet.

Ky ligj botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më / / 2021.

Miratuar në datën / / 2021.

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.10 112 DATË 9.4.2009
“PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESTAT E BANIMIT”

KRYETARI

Gramoz Ruçi

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR.10 112 DATË 9.4.2009
"PËR ADMINISTRIMIN E BASHKËPRONËSISË NË NDËRTESAT E BANIMIT"